



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1009/23 Datë: 26/07/2023

Në mbështetje të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funksionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ, Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-031 (GZ, Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 114-të, të mbajtur më datë 13.07.2023, mori:

VENDIM

I. Nuk akreditohen programet e studimit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë:

1. *Edukimi dhe kujdesi në fëmijërinë e hershme MA 60 ECTS (A);*
2. *Te drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit LLM 60 ECTS (A)*

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për akreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Edukimi dhe kujdesi në fëmijërinë e hershme MA 60 ECTS (A);</i>	Merita Shala
2.	<i>Te drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit LLM 60 (A)</i>	Arbnor Ajeti

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtarë) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit; *Edukimi dhe kujdesi në fëmijërinë e hershme MA 60 ECTS (A)*, vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje Anca Greere dhe Asnate Kazoka është organizuar më 12.04.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht vetëm tre (3), Pjesërisht katër (4) standarde.
2. Për programin e studimit; *Të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit LLM 60 (A)*, vizita me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje Johanese Falterbaum dhe Asnate Kazoka është organizuar më 04.05.2023, ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Substancialisht vetëm dy (2), Pjesërisht pesë (5) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 114-të, të mbajtur më datë 13.07.2023, ka shqyrtuar dokumentacionin e Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave, si dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala mund të parashtroj ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatim prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Vendimi i dërgohet:

- Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

